

VENDIM
Nr.78, datë 28.1.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.475, DATË 13.7.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË
NËPUNËSVE CIVILË, TË ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE,
NË KRYEMINISTRI, APARATET E MINISTRIVE TË LINJËS DHE ADMINISTRATËN E
PRESIDENTIT, TË KUVENDIT DHE NË KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Lidhja nr.4, që i bashkëlidhet vendimit nr.475, datë 13.7.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2008.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.4

Pozicioni	Kualifikimi/grada/titulli shkencor	Shtesa (lekë/muaj)
Zëvendësm ministër	Profesor	30 000
Drejtor i Kabinetit të Presidentit/Kryetarit të Kuvendit/Kryeministrit/Zëvendëskryeministrit Këshilltar i Presidentit/Kryetarit të Kuvendit/Kryeministrit/Zëvendëskryeministrit Ndihmës i Presidentit/Kryetarit të Kuvendit/Kryeministrit Sekretar i Përgjithshëm	Profesor i asociuar	25 000

Ndihmës i Zëvendëskryeministrit	Doktor i shkencave	20 000
Drejtor Kabineti i Ministrit		
Këshilltar i Ministrit		
Drejtor Departamenti	Doktor i shkencave	25 000
Drejtor i Përgjithshëm		
Drejtor		
Përgjegjës sektori	Studime të thelluara	10 000
Kryeinspektor	pasuniversitare/Master i nivelit të dytë.	
Koordinator	Studime specializuese	
Jurist	afatgjata	
Inspektor		
Specialist	Studime të thelluara	20 000
	pasuniversitare/Master i nivelit të dytë	

Shënim: Vlerat 20 000 lekë, për diplomat “Master i nivelit të dytë/Studime të thelluara pasuniversitare” dhe 25 000 lekë, për gradën shkencore “Doktor i shkencave”, aplikohen për nëpunësit civilë dhe funksionarët politikë, që i kanë përfutur diplomat përkatëse në universitetet, apo shkollat e larta, të vendeve të përcaktuara sipas listës që do t’i bashkëlidhet udhëzimit të përbashkët, të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Ministrisë së Financave dhe Departamentit të Administratës Publike (pika 11 e këtij vendimi).